



REPUBLIKA E SHQIPERISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

Nr. 79 Prot.

Tiranë, më 28/05/2026

V E N D I M

Nr. 1, datë 28/05/2026

P Ë R

**HAPJEN E PROCESIT TË KANDIDIMIT PËR DISA VENDE VAKANTE PËR
ANËTARË TË KOMISIONEVE TË ZGJEDHJEVE NË FAKULTETE (KZF)**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Rregulloren "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese 2024 – 2028, në Universitetin Politeknik të Tiranës", neni 6 dhe neni 7, urdhrin nr. 29, datë 14.05.2026 të Rektorit "Për shpalljen e fillimit të procesit zgjedhor dhe përcaktimin e datës së zhvillimit të zgjedhjeve të pjesshme në Universitetin Politeknik të Tiranës", Komisioni Institucional i Zgjedhjeve,

VENDOSI:

1. Hapjen e procesit të kandidimit për disa vende vakante për anëtarë të Komisioneve të Zgjedhjeve në Fakultete (KZF).
2. Kandidatët për anëtarë të KZF – ve vetëkandidohen pranë sekretarisë së KIZ.
3. Formulari i vetëkandidimit për anëtarë dhe sekretarë të KZF-ve plotësohet pranë sekretarisë së KIZ.
4. Kandidatët përfaqësues të studentëve, duhet të paraqesin vërtetimin që ndjekin studimet në Universitetin Politeknik të Tiranës.
5. Numri i vendeve vakante për çdo njësi kryesore është si më poshtë:
 - Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit 1 anëtar (përfaqësues i personelit akademik);
 - Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike 1 anëtar (përfaqësues i studentëve);
 - Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike 1 anëtar (përfaqësues i personelit akademik) dhe sekretar i KZF-së;

- Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit 2 anëtarë (1 anëtar përfaqësues i personelit akademik dhe 1 anëtar përfaqësues i studentëve);
 - Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës 2 anëtarë (1 anëtar përfaqësues i personelit akademik dhe 1 anëtar përfaqësues i studentëve);
6. Afati i vetëkandidimit për anëtarë të KZF – ve, është ditën e premte datë 29.05.2026 dhe ditën e hënë, datë 01.06.2026, ora 10:00 – 14:00.
7. Kandidimi për anëtarë dhe sekretarë të KZF-ve, kryhet pranë Sekretarisë së KIZ (Zyra e Sektorit Juridik në Rektorat nr. 116).

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

Edmond PERGEGA

Kryetar

Alfred PJETRI

Anëtar

Albina BASHOLLI

Anëtar

Anjeza DULAJ (GJINI)

Anëtar

Nelda KOTE

Anëtar

Irida GJOKA (MARKJA)

Anëtar

Klajdi QOSHI

Anëtar

Pietro BELBA

Anëtar

